



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKES SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Dokumenti Propozime dhe Propozime-Konkordancë të Propozimeve i Propozimeve-Takimi Office
Nr. Prop. 06/200/Do-152
Pratje No.
Data 30.10.2017
Date
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

KORAB R. SEJDIU

Deputet
Poslanik – Representative

Për / Za / For:	Z. Bedri Hamza, Ministër Ministria e Financave
Nga / Od / From:	Korab R. Sejdiu, Deputet
Data / Datum / Date:	27 tetor 2017
Referenca / Referenca / Reference:	
Lënda / Predment / Subject:	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim.

Çështja: Më 25 tetor 2017, Auditori i Përgjithshëm raportoi ndër të tjera për vitin 2016 se borxhi publik i Republikës së Kosovës ka kaluar shifrën prej €850 milion. Në raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2016 thuhet se prej këtij borxhi publik, mbi €420 milion burojnë nga letra me vlerë (bona të thesarit) të lëshuara nga Republika e Kosovës.

PYETJA 1: Z. Ministër, pasur parasysh këtë vlerë të lartë të letrave me vlerë të lëshuara nga Republika e Kosovës, a mendoni se ka bazë të mjaftueshme/duhur ligjore (i vetëdijshëm për Rregulloren MF-BQK 01/2014 dhe Ligjin për Maredhëniet e Detyrimeve) për të lëshuar këso letra me vlerë deri në këtë nivel? Nëse nuk mjafton, a keni në plan futjen në agjendën legjislative të një ligji për letrat me vlerë, që do të mbulonte edhe letrat me vlerë nga sektori publik, por potencialisht edhe ato në sektorin privat?

PYETJA 2: Z. Ministër, poashtu lidhur me letrat me vlerë të lëshuara nga Republika e Kosovës, dhe pasur parasysh se Kosova është prej pak shteteve që nuk ka “vlerësim kreditor” (“credit rating”) nga ndonjë agjenci vlerësuese, a planifikoni që të ndërmerri hapat e nevojshëm për të siguruar një vlerësim kreditor të Republikës së Kosovës, që të sigurohen kushte sa më të favorshme për Republikën e Kosovës kur lëshon letra me vlerë?

Email: Korab.Sejdiu@assembly-kosova.org
Tel: +377 (0)44 470 045
Skype: korab.r.sejdiu

Ndërtesa e Kuvendit
Sheshi Nëna Tereze
Kutia/Box 70
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKES SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Prigodur për: Propozim / Propozicion / Proposition / Projekt / Projekt / Project / Propozim / Propozicion / Proposition / Projekt / Projekt / Project / Propozim / Propozicion / Proposition / Projekt / Projekt / Project
Nr. Titull
Publikimit
Prigodur No. 06/2017/00-153
Data
Datum
Date: 30.10.2017
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

KORAB R. SEJDIU

Deputet
Poslanik – Representative

Për / Za / For:	Z. Flamur Sefaj, Ministër Ministria i Punëve të Brendshme
Nga / Od / From:	Korab R. Sejdiu, Deputet
Data / Datum / Date:	27 tetor 2017
Referenca / Referenca / Reference:	
Lënda / Predment / Subject:	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim.

Çështja: Ditëve të kaluara, dy media kredibile në Kosovë kanë raportuar se Mali i Zi ka filluar me ushtrimin e pushtetit faktik mbi një pjesë të territorit të Republikës së Kosovës, duke zbatuar marrëveshjen e demarkacionit të nënshkruar nga palët por e cila marrëveshje nuk ka efekt juridik për arsye të mos-ratifikimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Sipas ketyre mediave, ky fakt është konfirmuar edhe nga një anëtar i Komisionit Shtetëror. Këtë çështje e kam ngritur edhe në seancën plenare të Kuvendit të datës 25 tetor 2017, por nuk kam marrë përgjigje nga kabineti qeveritar.

PYETJA: Z. Ministër, pasur parasysh këto informatë shumë shqetësuese për qytetarët e Republikës së Kosovës, a keni ndërmarrë ndonjë hap konkret për të konfirmuar nëse këto informata janë të sakta? Nëse jo, çfarë hapash konkret do të ndërmerri për ti verifikuar këto informata, dhe nëse dalin të vërteta, çka do të ndërmerri për të evituar cenimin e integritetit territorial të Republikës së Kosovës?

Email: Korab.Sejdiu@assembly-kosova.org
Tel: +377 (0)44 470 045
Skype: korab.r.sejdiu

Ndërtesa e Kuvendit
Sheshi Nëna Tereze
Kutia/Box 70
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës